

AKT - THEMELIMI

(KONTRATË)

PËR

THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“LIDARINA” SH.P.K

Bazuar në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, liçensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Tiranë, sot, më datë 09.01.2025, unë Florjan Gorishova i biri i Agronit, i datëlindjes 18.12.1982 lindur në Vlorë e banues në Tiranë në adresën Rruga “Grigor Heba”, Nd.15, H.10, Ap.5 Njesia Administrative nr.5 mbajtës i pasaportës me nr. BI7961291 me nr personal I21218073U, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me vullnetin tim të lirë, vendosa të krijoj Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar **“LIDARINA” sh.p.k.**

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“LIDARINA” sh.p.k** me ortak themelues:

- Florjan Gorishova i biri i Agronit, i datëlindjes 18.12.1982 lindur në Vlorë e banues në Tiranë në adresën Rruga “Grigor Heba”, Nd.15, H.10, Ap.5 Njesia Administrative nr.5 mbajtës i pasaportës me nr. BI7961291 me nr personal I21218073U,

Neni 2

Shoqëria tregtare **“LIDARINA” sh.p.k** do të ketë selinë në adresën Rruga e Dibrës, Nd.10, Shk.4, Kati 8, Ap.18 Tiranë.

Veprimtaria e saj do të jetë me kohë të pacaktuar.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe ne cdo shtet tjetër të huaj, me miratim të Asamblesë

Florjan Gorishova

së Përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku do ta ushtrojë këtë veprimtari, duke zbatuar dispozitat dhe ligjet e vendit ku ushtron veprimtarinë.

Neni 3

Shoqëria **“LIDARINA” sh.p.k** është person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj zhvillohet sipas dispozitave të legjislacionit Shqiptar, kësaj kontrate dhe statutit të shoqërisë të cilat janë të pandashme.

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar dhe përgjigjet vetëm për pasurinë e vet dhe në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut/ortakëve jashtë kushteve të kësaj kontrate. Gjithashtu dhe ortakut/ortakët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë dhe nuk ngarkohen në asnjë rast për detyrimet jashtë kuotës së tyre në krijimin e shoqërisë përveç rasteve kur ai/ata vullnetarisht marrin përsiper një gjë të tillë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare **“LIDARINA” SH.P.K** është:

- Import - eksport.
- Tregëti e detergjenteve, aksesorëve, pjesë këmbimi, makineri e paisje larëse, automatike dhe manuale, shitje dhe dhënje me qira të makinerive dhe paisjeve larëse dhe aksesorëve të tyre, tregtim i materialeve elektrike dhe hidraulike, instalime elektrike dhe hidraulike.
- Autolavazho, dhënje me qera e sistemeve automatike të autolavazhove për të tretët, shërbime konsulence dhe suport teknik për këto sisteme.
- Shitje produktesh në platformat “on-line”.
- Montim dhe mirëmbajtje e sistemeve larëse të automjeteve të ndryshme, autolavazho, brenda dhe jashtë vendit.
- Tregëti e detergjenteve paisjeve dhe aksesorëve për higjienizimin e ambjenteve të banimit, social kulturore, hotele , restorante, ambjente biznesi etj.
- Import, tregëtim, projektim, zbatim dhe mirëmbajtje e impjanteve të pastrimit të ujit të pijshëm, impjante për trajtimin e ujerave të zeza, pishinave dhe ujërave industriale.
- Import, shitje dhe dhënje me qira e automjeteve e autoveturave të ndryshme.
- Ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta tregtare me subjekte vendase apo të huaja duke përfshirë edhe shërbime ndërmjetësimi dhe komisionimi .

Gorilla FORDAN

Veç sa më sipër në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjetër që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare të saj.

Neni 5

Kapitali themelor i shoqërise është caktuar në shumën 100.000 lekë dhe përbëhet nga 1 kuoët me vlerë nominale prej 100.000 leke .

Kapitali themelor i takon ortakut themelues si më poshte .

- **Florjan Gorishova eshte zoterues i kuotes se shoqërisë me vleren 100 000 lekë.**

Ortaku do të derdhë në llogaritë e shoqërisë shumën e caktuar brenda 90 ditëve nga data e rregjistrimit të shoqërisë në rregjistrin tregtar .

Neni 6

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj tregtare pas rregjistrimit të saj si person juridik në rregjistrin tregtar.

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqërise do të perdoret nga ortakët. Ortakët disponojnë lirisht fitimin e tyre.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- **Asamblea e Pergjithshme**
dhe
- **Administratori**

Asamblea e Pergjithshme ne momentin e themelimit dhe rregjistrimit te shoqërise perbehet nga ortakut i vetem themelues Florjan Gorishova.

Administrator i shoqërisë ne momentin e themelimit dhe rregjistrimit te shoqërise është Florjan Gorishova.

Mënyra e formimit dhe funksionimi i këtyre organeve përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 8

Ortakut/ët detyrohen të ruajnë karakterin e fshehtësisë të gjithë dokumentacionit , informatave etj. Duhet të merren masa të plota për të shmangur përhapjen e cdo të

Florjan Gorishova

dhëne që ka të bëjë me shoqërinë dhe që vlerësohet si sekret tregtar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 9

Shoqëria mund të kryejë cdo veprim juridik që ka të bëjë me objektin e veprimtarisë së saj.

Neni 10

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë me vendim të organit kompetent në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11

Dispozita të hollësishme për shoqërinë dhe funksionimin e saj përcaktohen në statutin e shoqërisë që i bashkangjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 12

Mosmarveshjet që mund të lindin midis palëve në se nuk gjëjnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 13

Kjo kontratë u përpilua në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Autorizohet administratori i shoqërisë, apo cdo person tjetër i autorizuar me prokurë prej tij, për depozitimin e këtij akti themelimi dhe statutit të shoqërisë "LIDARINA" shpk në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB dhe për përfaqësimin e shoqërisë në procesin e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.

Tiranë, më, 09.01.2025.

ORTAKU THEMELUES

FLORJAN GORISHOVA